



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Përkthim (C-A) (2)

Ngarkesa: 6 kredite, 20 leksione 40 seminare

Viti / Semestri ; Viti I , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Shkencor “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T’u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike mbi përkthimin teknik dhe institucional nga anglishtja në shqip në fusha si ligji, drejtësia, ekonomia, mjekësia etj. Të aftësojë studentët për të trajtuar tekstet e specializuara në përputhje me stilin funksional përkatës dhe kërkesat e përkthimit profesional. Të integrojë përdorimin e teknologjisë përkthimore si TRADOS dhe MULTITERM, duke zhvilluar kompetenca praktike për punën në mjedise bashkëkohore përkthimi.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojë aftësinë për të përdorur glosarë, fjalorë dygjuhësh dhe burime të tjera për të përkthyer në mënyrë të saktë dhe të qëndrueshme terma teknikë dhe institucionalë.
2. Të nxisë reflektimin mbi sfidat leksikore, gramatikore dhe stilistike që lidhen me përkthimin e teksteve profesionale dhe zbatimin e strategjive për zgjidhjen e tyre.
3. Të përfshijë analizën dhe krahasimin e versioneve të përkthimit të gjeneruara nga studentët dhe nga mjetet CAT për të rritur cilësinë e produktit përfundimtar.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të përkthejnë me saktësi tekste teknike dhe institucionale nga anglishtja në shqip, duke përdorur terminologjinë përkatëse sipas fushave të specializuara.
2. Do të zotërojnë aftësi praktike në përdorimin e TRADOS dhe në ndërtimin/përditësimin e bazës së termave në MULTITERM, si pjesë e përvojës përkthimore moderne.
3. Do të jenë në gjendje të analizojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë cilësinë e përkthimeve të tyre në kohë reale, duke përmirësuar autonominë, vetëvlerësimin dhe profesionalizmin.